



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 4723/12 .Prot

Gramsh më 07.01.2022

**VENDIM**

Nr. 129, datë 29.12.2021

**PËR**

**“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti datës 26.11.2019, si dhe shirat e rënë gjatë muajit Tetor të viti 2021 në banesën e z. Dylber Guri, banor në fshatin Lubinjw, Njësia Administrative Tunjë, si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti I datës 26.11.2019, si dhe shirat e rënë gjatë muajit Tetor 2021, në banesën e shtetasit **Z. Dylber Guri**, banor në fshatin Lubinjw, Njësia Administrative Tunjë, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **40%** të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $503\ 799 \times 40\% = 201\ 519$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Dylber Guri** është 201 519 (dyqind e një mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë ) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Dylber Guri, ndihmën emergjente në vlerën prej 201 519 (dyqind e një mijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë ) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2021.

4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Dylber Guri, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Dylber Guri, banesa e të cilit është dëmtuar nga forca madhore tërmeti i datës 26.11.2019, si dhe nga shirat e rënë gjatë muajti Tetor 2021.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektor i Emergjencave Civile ), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**Xhulia GJINI**



**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Greta LENA**

Konceptoi: Xh. Gjini

Pranoi: G. Lena

Dosja nr: \_\_\_\_\_

Afati i ruajtjes:

